<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>NR</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI</th> <th>KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Vendi</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Lundie</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Jug</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Perëndim</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>				NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI	KUFIRIT	KUFITARI	1	Vendi					2	Lundie					3	Jug					4	Perëndim				
NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI	KUFIRIT	KUFITARI																												
1	Vendi																																
2	Lundie																																
3	Jug																																
4	Perëndim																																
REALIZOI PËR IGJIU Ing. Eris NDRUKAJ KONFIRMOI PËR IGJIU DREJTORI MsC.ARK. Jurgën ÇOLAKU		TEKNOLOGJIA E MATJEVE <u>T.G.O.Z</u> PËRCAKTIMI I KUFIRIT Sipas matjeve në terren. SHËNIME TË VEÇANTA: Ky planrilevimi u hartua në zbatim të kartelës shoqëruese dërguar nga ASHK dhe protokolluar në Ministrinë e Mbrojtjes me nr.Prot. 4069 dt.16.07.2025 Bazuar në dokumentacionin hartografik arkivor, matjeve të kryera në terren.																															
REALIZOI PËR ASHK Specialisti _____ DVASHK _____ Nënskrimi _____ KONFIRMOI Përgjegjësi/Drejtori _____ Nënskrimi/Vula _____		PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM (Forca Detare) MIRATOHEJ KOMANDANTI Kundëradmiral Adnan KASTIJA																															



PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE i Pronës 1451 "FENERI PORT DJATHTAS" Sazan, Vlorë																																	
PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM (Forca Detare)		DATË 18/07/2025	QËLLIMI: PËRDITËSIM																														
VENDNDODHJA Bashkia Vlorë DVASHK/ZVASHK Vlorë Nr.Pasurisë _____ Z.K 3269 Indeksi i Hartës K-34-123-(122-C)																																	
TE DHËNAT E PASURISË Lloji i pasurisë: <u>TRUALL + NDËRTESE</u> Sip e pasurisë <u>20</u> m ² Sip e gjurmës së ndërtimit <u>9</u> m ² Nr. pemeve _____																																	
N= 4485705 980 E= 439152 076		KORNIZA REFERUESE (KRGJSH)																															
N= 4485705 980 E= 439152 076		N= 4485705 980 E= 439575 276																															
SHPJEGUESE: — Sip. e Përgj. e pronës 1451 = 20m ² Sip. nën objektin = 9m ²																																	
N= 4485354 910 E= 439152 076		N= 4485354 910 E= 439575 276																															
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>NR</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI</th> <th>KUFIRIT</th> <th>KUHTARI</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Vend</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Lindje</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Jug</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Perendim</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>				NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI	KUFIRIT	KUHTARI	1	Vend					2	Lindje					3	Jug					4	Perendim				
NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI	KUFIRIT	KUHTARI																												
1	Vend																																
2	Lindje																																
3	Jug																																
4	Perendim																																
REALIZOI PËR IGJIU Ing. Eris NDRUKAJ KONFIRMOI PËR IGJIU DREJTORI MSc.ARK. Jurgen ÇOLAKU		TEKNOLOGJIA E MATJEVE T.G.O.Z PËRCAKTIMI I KUFIRIT Sipas matjeve në terren. SHËNIME TË VEÇANTA: Ky planrilevimi u hartua në zbatim të kartelës shoqëruese dërguar nga ASHK dhe protokolluar në Ministrinë e Mbrojtjes me nr.Prot. 4069 dt.16.07.2025 Bazuar në dokumentacionin hartografik arkivor dhe matjeve në terren.																															
REALIZOI PËR ASHK Specialisti DVASHK Nenshkrimi KONFIRMOI Përgjegjësi/Drejtori Nenshkrimi/ Vula		PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM (Forca Detare) MIRATOHE KOMANDANT Kundëradmiral Adnan GASTRA																															

**VENDIM****Nr. 571, datë 8.10.2025****PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT
KOMBËTAR TË LEHTËSIRAVE
NË AVIACIONIN CIVIL DHE
ORGANIZIMIN E FUNKSIONIMIT E
KOMITETIT KOMBËTAR TË
LEHTËSIRAVE NË AVIACIONIN CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 129, të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Programit Kombëtar të Lehtësirave në Aviacionin Civil, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Për zbatimin e këtij programi ngrihet Komiteti Kombëtar i Lehtësirave në Aviacionin Civil (në vijim, Komiteti), i cili përbëhet nga:

a) drejtori ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil – kryetar;

b) një përfaqësues i nivelit të mesëm ose të lartë drejtues nga ministria përgjegjëse për transportin – anëtar;

c) drejtori i drejtorisë përgjegjëse për migracionin nga ministria përgjegjëse për punët e brendshme – anëtar;

ç) drejtori i drejtorisë përgjegjëse për lëshimin e pasaportave nga ministria përgjegjëse për punët e brendshme - anëtar;

d) një përfaqësues i nivelit të mesëm ose të lartë drejtues nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit – anëtar;

dh) drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave – anëtar;

e) një përfaqësues i nivelit të mesëm ose të lartë drejtues nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale – anëtar;

ë) një përfaqësues i nivelit të mesëm ose të lartë drejtues nga ministria përgjegjëse për turizmin – anëtar;

f) një përfaqësues i nivelit të mesëm ose të lartë drejtues nga ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural – anëtar;

g) përfaqësuesi i përzgjedhur nga operatorët ajrorë, që operojnë në Shqipëri – anëtar;

gj) përfaqësuesi i përzgjedhur nga operatorët e shërbimeve të përpunimit në tokë në aeroportet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë – anëtar;

h) drejtorët ekzekutivë të enteve menaxhuese të aeroporteve në Shqipëri.

3. Komiteti mblidhet dy herë në vit me njoftim të kryetarit. Komiteti mund të mbajë mbledhje *ad-hoc* kurdo që konsiderohet e nevojshme, me qëllim rishikimin e situatës së lehtësirave dhe gjetjen e zgjidhjeve për problemet që mund të hasen.

4. Në mbledhjet e Komitetit mund të ftohen të marrin pjesë ekspertë me njohuri specifike dhe që mund të përbëjnë një interes të veçantë për të.

5. Komiteti ka një sekretar, i cili është punonjës i Autoritetit të Aviacionit Civil dhe është përgjegjës për kryerjen e të gjitha përgatitjeve administrative për mbledhjet e Komitetit në bashkëpunim me kryetarin.

6. Data, ora dhe rendi i ditës së mbledhjes u njoftohen me shkrim anëtarëve të Komitetit të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara mbledhjes.

7. Për çdo mbledhje, sekretari i Komitetit mban procesverbal dhe e shpërndan tek anëtarët e Komitetit brenda 15 ditëve nga përfundimi i mbledhjes.

8. Ngarkohen Autoriteti i Aviacionit Civil dhe Komiteti Kombëtar i Lehtësirave në Aviacionin Civil për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****PROGRAMI KOMBËTAR I LEHTËSIRAVE
NË AVIACIONIN CIVIL SHQIPTAR****PËRMBAJTJA****KAPITULLI 1 – HYRJJE****1.1 Lehtësirat****1.2 Misioni**

1.3 Qëllimi dhe objektivat e Komitetit Kombëtar të Lehtësirave dhe PKLAC-së

KAPITULLI 2 – PËRKUFIZIME

KAPITULLI 3 – OBJEKTIVAT E PROGRAMIT KOMBËTAR TË LEHTËSIRAVE

KAPITULLI 4 – LEGJISLACIONI

Rregulloret ndërkombëtare

Rregulloret evropiane



Legjislacioni kombëtar

KAPITULLI 5 – ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I PROGRAMIT KOMBËTAR TË LEHTËSIRAVE

5.1 Komiteti Kombëtar i Lehtësirave

5.2 Anëtarët e Komitetit Kombëtar të Lehtësirave

5.3 Detyrat dhe programi i punës

5.4 Komiteti i Lehtësirave të Aeroportit

KAPITULLI 6 – PËRCAKTIMI I PËRGJEGJËSIVE

6.1 Autoriteti përgjegjës për PKLAC-në në Republikën e Shqipërisë

6.1.1 Të drejtat e pasagjerëve

6.2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

6.3 Ministria përgjegjëse për punët e brendshme, Drejtoria e Migracionit

6.4 Ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale

6.5 Ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural

6.6 Ministria përgjegjëse për turizmin

6.7 Operatorët ajrorë

6.8 Operatorët e aeroporteve

6.9 Operatorët e shërbimit të përpunimit në tokë

KAPITULLI 7 – AGJENCITË PËRGJEGJËSE PËR ZBATIMIN E DISPOZITAVE TË SIGURISË SË ANEKSIT 9

7.1 Mbërritja dhe nisja e avionëve

7.2 Mbërritja dhe nisja e pasagjerëve

7.3 Identifikimi dhe hyrja e ekuipazhit dhe e kategorive të tjera të personelit të operatorëve ajrorë

7.4 Mbërritja dhe nisja e kargos dhe e artikujve të tjerë

7.5 Personat e papranueshëm dhe të deportuarit

KAPITULLI 1

HYRJË

1.1 Lehtësirat

Lehtësirat janë një kombinim masash e burimesh njerëzore dhe materiale, që synojnë të përmirësojnë e të harmonizojnë lëvizjen e avionëve, ekuipazhit, pasagjerëve dhe kargos, duke siguruar pajtueshmërinë me legjislacionin përkatës kombëtar dhe detyrimet ligjore ndërkombëtare.

1.2 Misioni

Misioni i Programit Kombëtar të Lehtësirave në Aviacionin Civil (në vijim, PKLAC) është të mbajë një mjedis të sigurt të aviacionit civil, në të cilin

shërbimet kryhen në një mënyrë të besueshme dhe efikase.

1.3 Qëllimi i Komitetit Kombëtar të Lehtësirave në Aviacionin Civil dhe PKLAC-së

Ngritja e Komitetit Kombëtar të Lehtësirave në Aviacionin Civil (në vijim, KKLAC) dhe hartimi i PKLAC-së është kërkesë e përcaktuar në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë dhe në aneksin 9 të Konventës së Çikagos.

Qëllimi i PKLAC-së është të marrë angazhimin për përmirësimin e optimizimin e fluksit të avionëve, të ekuipazhit, të pasagjerëve e të kargos, duke hequr pengesat e vonesat e panevojshme, si dhe të përmirësojë shërbimin e klientit, ndërkohë që garantohen kërkesat e sigurisë në aviacion.

PKLAC-ja synon adresimin e harmonizimin e interesave të të gjitha subjekteve të përfshira në lehtësirat, si p.sh.: institucionet shtetërore, operatorët e avionëve, përdoruesit e transportit ajror tregtar dhe aeroportet, për të nxitur zhvillimin e sigurt e të besueshëm të transportit ajror.

Përfitimet e PKLAC-së janë:

a) ruajtja ose rritja e cilësisë së fluksit të lëvizjes së avionëve, ekuipazhit, pasagjerëve dhe kargos;

c) ruajtja ose rritja e nivelit të shërbimeve të pasagjerëve, efektivitetit ekonomik dhe efikasitetit të proceseve dhe procedurave;

ç) lehtësimi, rregullimi dhe nxitja e rritjes së transportit ajror; dhe

d) kontributi për krijimin e një përvoje pozitive, duke përmbushur kërkesat e udhëtarëve.

KAPITULLI 2

PËRKUFIZIME

Për zbatimin e PKLAC-së, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“Person shoqërues”**, një person madhor, i cili shoqëron një shtetas shqiptar të mitur deri në moshën 16 vjeç, për të udhëtuar jashtë territorit shqiptar, i pajisur me deklaratë noteriale nga të dy prindërit, nga prindi i shpallur i vetëm, sipas certifikatës së lëshuar nga organi kompetent i gjendjes civile apo gjykata ose nga kujdestari ligjor i shpallur si i tillë nëpërmjet vendimit gjyqësor për të gjitha rastet e parashikuara në legjislacionin shqiptar mbi përgjegjësinë, zotësinë, kujdestarinë prindërore apo kur njëri prind ka ndërruar jetë;



b) **“Pranimi”**, leja e dhënë për një person për të hyrë në një shtet nga autoritetet shtetërore të atij shteti, në përputhje me rregullat kombëtare;

c) **“Sistemi i Informacionit të Avancuar për Pasagjerët (API)”**, një sistem komunikimi elektronik, ku të dhënat grumbullohen dhe u transmetohen agjencive të kontrollit të kufirit përpara fluturimit të nisjes apo mbërritjes dhe janë të disponueshme në aeroportin e hyrjes;

ç) **“Pajisjet e avionit”**, pajisje, duke përfshirë ato të ndihmës së shpejtë dhe pajisjet e mbijetesës, por jo pjesët e avionit apo furnizimet, që kanë për qëllim të përdoren në bord të avionit;

d) **“Operator i avionit”**, një person, organizatë apo ndërmarrje tregtare, që përfshihet apo ofron të përfshihet në operimin e avionit;

dh) **“Dokumentet e operatorit të avionit”**, fatura/dokumente dërgesash, bileta pasagjerësh apo karta bordi, plane dokumentesh bankare, bileta bagazhesh, raporte dëmsh apo parregullsish, orare, shenja për kargo dhe bagazhet, si dhe dokumente për peshën e balancën e operatorëve ajrorë;

e) **“Transportues ajror”**, çdo sipërmarrje tregtare e transportit ajror, që ofron apo operon shërbime transporti ajror për pasagjerët, ngarkesat dhe/ose postën për qëllim fitimi dhe/ose shpërblymi.

KAPITULLI 3

OBJEKTIVAT E PKLAC-së

Objektivi kryesor i PKLAC-së është që të bëjë koordinimin ndërmjet organeve përkatëse dhe entiteteve, që janë të përfshira në këtë program, në mënyrë që:

- të garantojë zbatimin e të gjithë legjislacionit përkatës;
- të përmirësojë proceset e procedurat;
- të mbështesë në mënyrë proaktive zhvillimin e strategjive të avancuara për të adresuar çështjet e lehtësirave në industrinë e transportit ajror.

KAPITULLI 4

LEGJISLACIONI

PKLAC-ja bazohet në ligjet e në rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në zbatim të Konventës së Çikagos:

- çdo avion, që hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të zbresë në një aeroport të caktuar

nga Republika e Shqipërisë, për qëllimin e kontrollit doganor dhe të kontrolleve të tjera. Edhe nisja nga territori i Republikës së Shqipërisë do të kryhet nga një aeroport doganor i caktuar në mënyrë të ngjashme;

- ligjet dhe aktet nënligjore në Republikën e Shqipërisë, lidhur me pranimin ose largimin nga territori i saj i pasagjerëve, ekuipazhit ose kargos e postës, të tilla si aktet që kanë të bëjnë me hyrjen, zhdoganimin, imigrimin, pasaportat dhe karantinën, zbatohen nga ose në emër të këtyre pasagjerëve, të ekuipazhit ose të ngarkesës në hyrje apo në nisje nga ose gjatë qëndrimit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

- Republika e Shqipërisë ka pranuar të marrë masa efektive për parandalimin e përhapjes nëpërmjet transportit ajror të kolerës, tifos (epidemi), lisë, etheve të verdha, murtajës dhe sëmundjeve të tjera ngjitëse;

- Republika e Shqipërisë ka pranuar të miratojë të gjitha masat e zbatueshme, nëpërmjet nxjerrjes së rregulloreve të veçanta, për të lehtësuar dhe përsheptuar transportin me avion ndërmjet territoreve të shteteve kontraktuese të Konventës së Çikagos dhe për të parandaluar vonesa të panevojshme për avionët, ekuipazhet, pasagjerët dhe kargon, sidomos me zbatimin e ligjeve që kanë të bëjnë me migracionin, karantinën, kontrollet doganore;

- Republika e Shqipërisë ka vendosur procedurat doganore dhe ato të migracionit, që ndikojnë në transportin ajror ndërkombëtar, në përputhje edhe me praktikën që krijohen ose rekomandohen herë pas here, në bazë të Konventës së Çikagos;

- Republika e Shqipërisë ka marrë përsipër të bashkëpunojë për sigurimin e shkallës më të lartë praktike të uniformitetit në rregulloret, standardet, procedurat dhe organizimin, në lidhje me avionët, personelin, rrugët ajrore dhe shërbimet ndihmëse në të gjitha çështjet, në të cilat një uniformitet i tillë do të lehtësojë dhe do të përmirësojë transportin ajror.

PKLAC-ja merr në konsideratë standardet e mëposhtme ndërkombëtare:

Akte ndërkombëtare

- Konventa e Çikagos për Aviacionin Civil dhe në veçanti nenet 10, 13, 14, 22, 23, 37 dhe 38;

- Aneksi 9 i Konventës së Çikagos – Lehtësirat;

- Konventa për Unifikimin e disa Rregullave për Transportin Ajror Ndërkombëtar (Konventa e Montrealit);



- Konventa Ndërkombëtare për Thjeshtëzimin dhe Harmonizimin e Procedurave Doganore (Konventa e *Kyoto-s*);

- Dokumenti 9944 i ICAO-s “Udhëzime mbi të dhënat e rekordeve të emrave të pasagjerëve”;

- Dokumenti 9984 i ICAO-s “Manual mbi aksesin në transportin ajror të personave me aftësi të kufizuara”;

- Dokumenti 9303 i ICAO-s “Dokumentet e udhëtimit që lexohen nga makineria”;

- Rregullorja Ndërkombëtare e Shëndetit.

Rregulloret evropiane

- Rregullorja e Komisionit (BE) nr. 300/2008, mbi rregullat e përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil;

- Rregullore e Komisionit (BE) nr. 1998/2015, mbi përcaktimin e masave të detajuara për zbatimin e standardeve të përbashkëta bazë në fushën e sigurisë së aviacionit civil;

- Rregullore e Komisionit Evropian nr. 889/2002, mbi përgjegjësinë e një kompanie ajrore në rast aksidentesh (Konventa e Montrealit);

- Rregullore e Komisionit Evropian nr. 261/2004, mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastet e mohimit të hipjes në bord të avionit, anulimit të fluturimeve apo vonesave të gjata;

- Rregullore e Komisionit Evropian nr. 2111/2005, mbi përcaktimin e një liste të komunitetit për kompanitë ajrore, të cilave u është mohuar operimi brenda komunitetit dhe informimin e pasagjerëve të transportit ajror mbi identitetin e këtyre kompanive;

- Rregullore e Komisionit Evropian nr. 1107/2006, mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizje të reduktuar gjatë udhëtimit nga ajri;

- Rregullore e Komisionit Evropian nr. 562/2006, mbi vendosjen e një kodi të komunitetit për rregullat, që kanë për qëllim lëvizjen e personave përgjatë kufijve (Kodi për Kufijtë *Schengen*);

- Rregullore e Komisionit Evropian nr. 810/2009, mbi vendosjen e një kodi vizash të komunitetit (Kodi i Vizave) – versioni i konsoliduar i shkurtit të vitit 2012;

- Rregullore e Këshillit të Evropës nr. 2913/92, mbi vendosjen e një kodi doganor të komunitetit;

- Rregullore e Komisionit Evropian nr. 2454/93, mbi përcaktimin e dispozitave për zbatimin e Kodit Doganor të Komunitetit;

- Deklarata mbi Politikën në Fushën e Faciliteteve të Aviacionit Civil dhe Dokumenti 30 i ECA-së (Konferenca Evropiane e Aviacionit Civil), pjesa I, përfshirë seksionet e saj.

Legjislacioni kombëtar

- Ligji nr. 96/20, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”;

- Vendimi nr. 411, datë 19.6.2024, i Këshillit të Ministrave, “Për Programin Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil”;

- Vendimi nr. 821, datë 24.12.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e standardeve bazë për ruajtjen e aviacionit civil nga aktet e ndërhyrjes së paligjshme, që rrezikojnë sigurinë e aviacionit civil”;

- Udhëzimi nr. 26, datë 20.10.2010, “Për rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, ndryshuar me udhëzimin nr. 16, datë 29.9.2011, të ministrit;

- Urdhri nr. 163, datë 26.3.2021, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e masave të detajuara për zbatimin e standardeve themelore të përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, i ndryshuar;

- Udhëzimi nr. 2, datë 13.3.2015, “Për plotësimin e standardeve të përgjithshme bazë në sigurinë e aviacionit civil, të përcaktuara në aneksin e udhëzimit të ministrit nr. 26, datë 20.10.2010”;

- Vendimi nr. 772, datë 24.9.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit”;

- Ligji nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”.

KAPITULLI 5

ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I PROGRAMIT KOMBËTAR TË LEHTËSIRAVE

5.1 Komiteti Kombëtar i Lehtësirave në Aviacionin Civil

Për të zbatuar e për të menaxhuar kërkesat e PKLAC-së në Republikën e Shqipërisë, krijohet Komiteti Kombëtar i Lehtësirave në Aviacionin Civil (në vijim, KKLAC).

KKLAC-ja përmirëson proceset e procedurat dhe mbështet në mënyrë proaktive zhvillimin e



strategjive të avancuara për të adresuar çështjet e lehtësirave në industrinë e transportit ajror.

Përgjegjësitë e KKLAC-së janë, si më poshtë vijon:

1. Të garantojë koordinimin ndërmjet organeve përkatëse, institucioneve të tjera shtetërore dhe industrisë, për të hequr pengesat e panevojshme dhe vonesat, si edhe për të përmirësuar nivelin e shërbimit në aeroporte;

2. Të zhvillojë dhe të zbatojë PKLAC-në, në përputhje me kërkesat e aneksit 9 të Konventës së Çikagos;

3. Të marrë parasysh rekomandimet e bëra nga subjektet (si p.sh. komitetet e sigurisë së aeroportit ose Komiteti i Lehtësirave të Aeroportit), të cilat nuk janë anëtarë të Komitetit Kombëtar të Lehtësirave;

4. Të inkurajojë zhvillimin e praktikave më të mira në të gjitha fushat e lehtësirave (p.sh.: migracioni, dogana, trajtimi i personave me aftësi të kufizuara);

5. Të jetë një forum për diskutimin e ndryshimeve të propozuara për rregulloret, që kanë të bëjnë me lehtësirat;

6. Të informojë institucionet dhe organizatat e tjera të interesuara për zhvillimet përkatëse të rëndësishme në fushën e aviacionit civil (p.sh. rezultatet e panelit të lehtësirave të ICAO-s), t'u bëjë atyre rekomandime, që lidhen me PKLAC-në, si dhe t'i bëjë pjesë të takimeve, sipas nevojave;

7. Të koordinojë me Komitetin Kombëtar të Sigurisë në Aviacionin Civil për çështje të sigurisë së aviacionit civil.

Për adresimin e aspekteve të ndryshme të lehtësirave shërbejnë grupet dhe forumet e ndryshme. Ndër to mund të përmenden (por pa u kufizuar në to): Komiteti i Lehtësirave të Aeroportit, Komiteti i Sigurisë së Aeroportit, Komiteti i Përdoruesve të Aeroportit etj. Ndërmjet këtyre komiteve dhe KKLAC-së duhet të ketë ndërveprim e shpërndarje informacioni.

5.2 Anëtarët e KKLAC-së

KKLAC-ja përbëhet nga zyrtarë, të cilët përfaqësojnë interesat në fushat përkatëse të lehtësirave. Kryetari i KKLAC-së mund të ftojë ekspertë për të këshilluar ose kontribuar në çështje të veçanta.

Komiteti Kombëtar i Lehtësirave në Aviacionin Civil organizohet dhe funksionon në përputhje me këtë vendim të Këshillit të Ministrave.

5.3 Detyrat dhe programi i punës

KKLAC-ja:

- do të vlerësojë rregullisht nivelin e lehtësirave në aeroportet ndërkombëtare të vendit;

- do të marrë në shqyrtim e do të rekomandojë zgjidhje për çështjet e lehtësirave;

- do të informohet rregullisht për funksionimin e Komitetit të Lehtësirave në Aeroporte për të siguruar që praktikat dhe/ose procedurat e përdorura në aeroportet janë në përputhje me legjislacionin kombëtar e ndërkombëtar;

- do të marrë në shqyrtim ndryshimet e propozuara në legjislacionin ndërkombëtar dhe do të japë të dhëna për hartimin e politikës kombëtare në zbatim të tyre;

- do të përditësohet me dispozitat e aneksit 9 të Konventës së Çikagos dhe zbatimin e tyre nëpërmjet praktikave dhe procedurave në nivel kombëtar, me qëllim që të vendosë një përputhshmëri;

- do të identifikojë dhe do të përdorë informacionin nga çdo subjekt pjesëmarrës për zhvillimet në fushën përkatëse të tyre, që mund të dëmtojë lehtësirat;

- do të sigurojë që komitetet e lehtësirave të aeroportëve të mbledhen rregullisht për të monitoruar e vlerësuar progresin e tyre.

KKLAC-ja përcakton prioritetet dhe agjendën sipas një programi vjetor.

KKLAC-ja mund të organizojë punën nëpërmjet takimeve të nëngrupeve të dedikuara për probleme të ndryshme, për qëllime efektiviteti e efikasiteti. Rezultatet e nëngrupeve i raportohen KKLAC-së.

5.4 Komiteti i Lehtësirave të Aeroportit

Komiteti i Lehtësirave të Aeroportit duhet të ngrihet në çdo aeroport, me qëllim koordinimin e çështjeve të faciliteteve në nivel aeroporti.

Komiteti i Lehtësirave të Aeroportit (i kryesuar nga operatori i aeroportit) duhet të përbëhet nga përfaqësuesit kryesorë të lehtësirave në aeroport, të cilët përfshijnë, por pa u kufizuar, si më poshtë vijon:

- drejtorin ekzekutiv të aeroportit – kryetar;

- përfaqësues nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

- përfaqësues nga ministria përgjegjëse për transportin;

- përfaqësues nga ministria përgjegjëse për rendin publik;

- përfaqësues nga autoriteti përgjegjës për doganën në aeroport;



- përfaqësues nga ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror;

- drejtuesin e Kufirit dhe Migracionit në aeroport;

- përfaqësuesi i autoritetit shëndetësor të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

- drejtuesin e sigurisë së aeroportit;

- një përfaqësues nga çdo operator ajror vendas e përfaqësues të kompanive të shërbimit në tokë;

- përfaqësuesin e operatorëve ajrorë.

Drejtimi i Komitetit të Lehtësirave të Aeroportit:

- Drejtori ekzekutiv i aeroportit kryeson e drejton komitetin, në lidhje me lehtësirat, menaxhon seancat e mbledhjes dhe punën e Komitetit;

- Komiteti i Lehtësirave të Aeroportit mblidhet çdo tre muaj ose sa herë që të kërkohet.

Komiteti i Lehtësirave të Aeroportit ka detyrat e mëposhtme:

1. Koordinimi dhe kontrolli i zbatimit të masave të përcaktuara në PKLAC.

2. Garantimi i koordinimit të duhur ndërmjet departamenteve dhe autoriteteve të përfshira në PKLAC;

3. Zbatimi i udhëzimeve që kanë synim përmirësimin e eficiencës së procedurave të lehtësirave në aeroport;

4. Zbardhja dhe dërgimi i minutave të takimit të mbledhjeve të Komitetit tek autoritetet përkatëse, për veprime të mëtejshme;

5. Ndjekja e zbatimit të vendimeve të marra nga autoritetet përkatëse dhe ajo çka është rekomanduar në mbledhjet e KKLCA-së;

6. Monitorimi, dhënia e miratimeve, rishikimi dhe rregullimi i procedurave të mbërritjes së fluturimeve në aeroport, si të jetë e përshtatshme;

7. Rishikimi i rregullt i performancës së të gjitha palëve të përfshira, me një target prej 45 minutash për të përfunduar procedurat e pasagjerëve në mbërritje dhe 60 minutash për procedurat e pasagjerëve në nisje. Përdorimi i studimeve të bazuara në kohën e pritjes dhe radhët, për të vendosur përmirësimet e nevojshme;

8. Përdorimi i sistemeve moderne të kontrollit të pasaportave dhe kontrollit doganor, përdorimi i teknologjisë së disponueshme dhe bashkëpunimi në zhvillimin e sistemeve të automatizuara për procedurat e përpunimit të pasagjerëve;

9. Procedurat për ndryshimin e fluksit të trafikut të pasagjerëve dhe përballimi i fluksit në pikat e kontrollit të sigurisë;

10. Përmirësimi i cilësisë dhe i sasisë së shenjave dhe orientimit në aeroport për të shmangur konfuzionin e pasagjerëve dhe për të lehtësuar aksesin e pasagjerëve në aeroport;

11. Sigurimi i pajisjeve të duhura dhe të nevojshme për lëvizjen e pasagjerëve invalidë dhe personave me aftësi të kufizuara lëvizëse;

12. Monitorimi dhe ndjekja e pranisë së nevojshme të stafit në pika, turneve, orëve jashtë orarit dhe kërkimi i përmirësimeve, nëse është e nevojshme;

13. Ndjekja dhe përmirësimi i procedurave të shpërndarjes së bagazheve në mbërritje;

14. Koordinimi i lehtësirave, kontrollit të narkotikëve, sigurisë së aviacionit dhe rrezikut të substancave të rrezikshme, në mënyrë që të përmbushen të gjithë objektivat e PKLAC-së;

15. Koordinimi i aktiviteteve dhe i kërkesave për të garantuar përfundim të shpejtë të procedurave të shpërndarjes së kargos, si edhe sigurimi i ambienteve të duhura për ngarkim/shkarkim, në mënyrë që mallrat të magazinohen në një mënyrë të sigurt, teksa pritët përfundimi i procedurave të doganës;

16. Vendosja e sistemeve elektronike për hartimin e mirëmbajtjen e listave të kargos dhe kryerjen e procedurave doganore;

17. Vendosja e mekanizmave për lehtësimin e procedurave shëndetësore;

18. Rishikimi i rregullt i performancës së të gjithë aktorëve, në lidhje me përmbushjen e targetit për përfundimin e formaliteteve të kontrollit të kargos brenda një afati prej tre orësh.

KAPITULLI 6

PËRCAKTIMI I PËRGJEGJËSIVE

Ky kapitull përshkruan ndarjen e përgjegjësiave për zbatimin e çështjeve të lehtësirave dhe përcakton shembuj të detyrave, që lidhen me çështjet e lehtësirave të caktuara për organizmat brenda fushës së tyre të kompetencës.

6.1 Autoriteti përgjegjës për PKLAC-në

AAC-ja ushtron funksionet e autoritetit kombëtar për rregullimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha veprimtarive në fushën e transportit ajror, në përputhje me Kodin Ajror, aktet e tjera ligjore e



nënligjore në zbatim të tij, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare.

AAC-ja është autoriteti përgjegjës i caktuar si koordinatori i përgjithshëm i PKLAC-së. Kryetari i KKLAC-së është përgjegjës për thirrjen e mbledhjeve të rregullta dhe *ad-hoc* të KKLAC-së dhe për të siguruar që politikat dhe/ose rregullat e propozuara nga KKLAC-ja janë adoptuar e përpunuar për t'u përfshirë në legjislacionin kombëtar nga autoritetet përkatëse. Autoriteti i caktuar koordinon me ministritë përgjegjëse, të cilat mbajnë përgjegjësi të plotë për fushat e tyre përkatëse të kompetencës.

Përgjegjësitë e autoritetit përgjegjës për lehtësirat janë, si më poshtë vijon:

a) Të sigurojë një përputhje ndërmjet PKLAC-së dhe Programit Kombëtar të Sigurisë në Aviacionin Civil (PKSAC);

b) Të mundësojë mbështetje administrative (sekretariat) për KKLAC-në dhe të marrë masa për organizimin e takimeve të këtij Komiteti;

c) Të sigurojë përputhje me standardet e praktikat e rekomanduara të përshkruara në aneksin 9 të Konventës së Çikagos dhe, nëse është e nevojshme, të evidentojë diferencat dhe të njoftojë ICAO-n;

d) Të sigurojë që operimet janë kryer në një mënyrë të tillë që të përmbushin një përputhje efektive me kërkesat kombëtare dhe produktivitetin e operatorëve, aeroporteve dhe agjencive shtetërore të përfshira.

Gjithashtu, Autoriteti i Aviacionit Civil, në cilësinë e institucionit përgjegjës për sigurinë e aviacionit civil, ka përgjegjësi, si më poshtë vijon:

a) Të marrë masa që burimet mbështetëse dhe lehtësirat e kërkuara nga shërbimet e sigurisë së aviacionit të jenë të disponueshme në çdo aeroport që i shërben aviacionit civil;

b) Të koordinojë dhe të punojë me institucione të tjera qeveritare, si edhe me operatorët ajrorë e operatorët e aeroportit për zbatimin e masave të sigurisë, me qëllim minimizimin e vonesave të panevojshme në lëvizjen e pasagjerëve, bagazheve, kargos dhe avionëve;

c) Të sigurojë përdorimin eficient të metodave të kontrollit dhe skanimit të pasagjerëve, bagazheve, kargos e postës që të lehtësojë, kurdo që është e mundur, me kushtin që të mos cenohen procedurat dhe kontrollet e sigurisë;

ç) Të lejojë përshtatjen e procedurave, lehtësirave dhe nismave për të lehtësuar lëvizjen e udhëtarëve, bagazheve, kargos dhe avionëve, për aq kohë sa të gjitha masat e tjera të sigurisë dhe kontrollet e tjera zbatohen sipas kërkesave;

d) Të koordinojë me autoritetin e migracionit/autoritetin përgjegjës për lëshimin e pasaportave /vizave/dokumenteve të udhëtimit për të siguruar që teknologjia e përdorur për këtë proces lehtëson procedurat për pasagjerin.

6.1.1 Të drejtat e pasagjerëve

AAC-ja është autoriteti kompetent zbatues për mbrojtjen e të drejtave të pasagjerëve dhe të të drejtave të invalidëve dhe personave me aftësi të kufizuara, kur udhëtojnë nëpërmjet ajrit.

Në këtë kuadër, AAC-ja duhet të garantojë që të drejtat e pasagjerëve të jenë të mbrojtura, duke përfshirë:

i. të drejtën e pasagjerëve me lëvizje të kufizuar për të pasur akses të barabartë në transportin ajror;

ii. të drejtën e pasagjerëve për asistencë dhe, kur është e nevojshme, kompensimin në rastet e mohimit të hipjes në bord, anulimit të fluturimeve, vonesave të gjata, problemeve me bagazhet etj.

Për këtë, AAC-ja:

a) mbikëqyr respektimin e të drejtave të pasagjerëve nga aeroporti dhe operatorët e avionit;

b) raporton konkluzione dhe rekomandime në njësinë kombëtare për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve dhe në institucionet përkatëse të Bashkimit Evropian;

c) ndjek trajtimin e ankesave të pasagjerëve deri në kompensim/zgjidhje të tyre;

ç) aplikon rekomandime ndaj operatorëve ajrorë dhe aeroportualë, sipas deklaratës mbi politikën në fushën e faciliteteve të aviacionit civil, dokumentin 30, i ECAC-së, pjesa I, seksioni 5 për të siguruar ofrimin e shërbimeve të nevojshme dhe cilësore ndaj invalidëve dhe personave me aftësi të kufizuara kur udhëtojnë me transport ajror;

d) bashkëpunon me operatorët ajrorë, aeroportualë, institucionet homologe, shoqatat e konsumatorëve etj., mbi respektimin e të drejtave të pasagjerëve;

dh) merr pjesë në Komitetin Kombëtar të Lehtësirave.

6.2 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Përgjegjësitë e veçanta në fushën e lehtësirave janë:



a) mbikëqyrja e pasagjerëve në mbërritje/nisje, kargos dhe postës, me qëllim që të sigurohet zbatimi i legjislacionit kombëtar;

b) në zbatim të standardeve të lehtësirave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të përcaktojë lehtësirat që do të stimulojnë transmetimin elektronik të informacionit të kërkuar për mbërritjen dhe nisjen e avionëve;

c) përdorimi i procedurave të thjeshtësuara për lejimin e daljes ose të hyrjes së mallrave në vend;

ç) konfiskimi i të gjitha mallrave të ndaluara dhe ndalimi i mallrave të kufizuara (deri në sigurimin e certifikatës përkatëse, kur është e aplikueshme);

d) pjesëmarrja në Komitetin e Lehtësirave dhe, nëse kërkohet, në mbledhje të tjera që lidhen me lehtësirat.

6.3 Ministria përgjegjëse për punët e brendshme, Drejtoria e Migracionit

Përgjegjësitë e veçanta në fushën e lehtësirave janë, si më poshtë vijon:

a) lëshimi i dokumenteve të udhëtimit dhe konfirmimi që dokumentet e udhëtimit të lexueshme nga pajisja përkatëse janë në përputhje me specifikimet e dokumentit 9303 të ICAO-s, me qëllim që të garantohet lexueshmëria e tyre në mbarë botën në makinat lexuese të prodhimeve të ndryshme;

b) kontrolli i vlefshmërisë dhe i pranueshmërisë së dokumenteve të udhëtimit në pikat e kontrollit kufitar;

c) zbulimi dhe ndalimi i udhëtimit të terroristëve ose të kriminelëve të tjerë, të cilët mund të paraqesin një kërcënim për aviacionin civil dhe shtetin;

ç) zhvillimi dhe adoptimi i një politike aktive në ndarjen e informacionit me strukturat e tjera dhe shtetet fqinje për të mbrojtur kufijtë shtetërorë kundrejt pasojave negative të imigrimit të paligjshëm;

d) njoftimi pa vonesë i shteteve të tjera, brenda kuadrit ligjor kombëtar e ndërkombëtar, në rast të zotërimit të informacionit apo elementeve të forta, që tregojnë lëvizje emigruese të paligjshme, të cilat mund të shkaktojnë turbullira apo mund të rrezikojnë rendin dhe sigurinë publike;

dh) bashkëpunimi dhe asistimi i operatorëve ajrorë në përcaktimin e vlefshmërisë dhe origjinalitetit të dokumenteve të udhëtimit;

e) informimi i operatorëve mbi kërkesat e autoritetit kompetent, në lidhje me hyrjen, kalimin transit dhe nisjen e pasagjerëve;

ë) në rast aksidentesh ajrore, pranimin pa vonesë, përkohësisht dhe pa pasur nevojën e pasjes së dokumenteve të tjera të udhëtimit, përveç pasaportës, të ekspertëve të kërkimit, shpëtimit, investigimit dhe riparimit apo shpëtimit të avionëve, në përputhje me anekset 12 e 13 të Konventës së Çikagos;

f) dhënia e vizës së udhëtimit, kur kërkohet, për ekspertët e investigimit, të cilët vijnë me misione të lidhura me një aksident ajror;

g) përshtatja e masave për lehtësimin e kthimit të personave të papranueshëm dhe të të deportuarve;

gj) përshtatja e masave për të parandaluar që personat, të konsideruar të papranueshëm apo të deportuarit, të krijojnë trazira apo të cenojnë ligjin, rendin publik dhe sigurinë në vende transit apo destinacione;

h) garantimi i zbatimit të standardeve për lehtësirat në lidhje me personat e papranueshëm apo të deportuarit;

i) pjesëmarrja në KKLAC dhe, nëse kërkohet, në takime të tjera që kanë të bëjnë me lehtësirat;

j) dhënia e ndihmës së mjaftueshme për operatorët, pa pagesë.

6.4 Ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale

Sipas nenit 14 të Konventës së Çikagos, duhet të merren masa efektive, me qëllim parandalimin e përhapjes së sëmundjeve nga ajri. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale luan rolin e monitorimit të kapaciteteve, që përmbushen nga autoritetet e aeroportit.

Përgjegjësitë e veçanta në fushën e lehtësirave janë, si më poshtë vijon:

a) bashkëpunimi në mënyrë aktive me Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe shtetet e tjera për të garantuar zbatimin efektiv të Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit;

b) identifikimi i ngjarjeve, lidhur me sëmundje apo vdekje mbi nivelin e parashikuar, gjatë një periudhe të caktuar, në të gjithë hapësirën e shtetit;

c) raportimi në mënyrë të menjëhershme të të gjithë informacionit të disponueshëm dhe esencial tek të gjitha nivelet përgjegjëse për shëndetësinë;

ç) zbatimi i kontrolleve paraprake (kundër përhapjes së sëmundjeve) në mënyrë të menjëhershme;

d) reagimi në mënyrë të shpejtë e të menjëhershme ndaj reziqeve të shëndetit publik, si



edhe emergjencave shëndetësore me natyrë ndërkombëtare;

dh) garantimi i dezinfektimit dhe dezinfektimit të avionit, sipas rekomandimeve të OBSH-së dhe në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit;

e) dhënia e ndihmës dhe lehtësimi për vaksinimin, vendosjen e karantinës (kur duhet) dhe lëshimin e certifikatave të nevojshme;

ë) garantimi, në bashkëpunim me aeroportet dhe operatorët e avionit, që përgatitja e ushqimit, magazinimi, shërbimi, si edhe furnizimi me ujë apo furnizime të tjera, të destinuara për t'u përdorur në aeroport apo në avion, të përmbushin kushtet e higjienës dhe të jenë në përputhje me standardet e vendosura nga OBSH-ja dhe Organizata Ndërkombëtare e Bujqësisë dhe Ushqimit;

f) njoftimi i OBSH-së në mënyrë të menjëhershme dhe në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, për çdo informacion të lidhur me rreziqet ndaj shëndetit të një natyre ndërkombëtare;

g) garantimi i aksesit në shërbimet e nevojshme shëndetësore, duke përfshirë edhe lehtësirat në diagnostikim, në mënyrë që të bëhet një vlerësim i shpejtë e të jepet kujdesi i nevojshëm për udhëtarët e sëmurë dhe punonjësit e aeroportit;

gj) hartimi dhe mirëmbajtja e një plani kontingjencash për emergjencat shëndetësore, në mënyrë që të garantohet reagimi i shpejtë dhe i duhur ndaj emergjencave shëndetësore me natyrë ndërkombëtare;

h) garantimi i një hapësire të veçantë në aeroport, të ndarë nga pjesa ku janë pasagjerët, me qëllim intervistimin e personave të prekur apo të dyshuar se janë prekur nga sëmundje;

i) vlerësimi i gjendjes shëndetësore dhe, nëse është e nevojshme, vendosja e karantinës për udhëtarët e dyshuar si të prekur;

j) aplikimi i kontrolleve në hyrje dhe dalje për personat që vijnë dhe nisen;

k) pjesëmarrja në mbledhjet e KKLAC-së.

6.5 Ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural

Në lidhje me lehtësirat, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duhet:

a) të garantojë që bimët dhe kafshët për eksport apo import të transportohen, në përputhje me rregullat e zbatueshme të transportit dhe të kenë certifikimin e nevojshëm nga agjencitë kompetente;

b) të bashkëpunojë ngushtë dhe të konsultohet vazhdimisht me agjencitë/institucionet ndërkombëtare që merren me çështjet e ushqimit, bujqësisë dhe kafshëve, në mënyrë që të përditësohet me zhvillimet më të fundit e të njoftojë Komitetin e Lehtësirave të Aeroportit apo palët e interesuara për këto zhvillime dhe pasojat që mund të kenë në aviacionin civil;

c) të përdorë metodat dhe mjetet e duhura në rastet e problemeve shëndetësore të kafshëve;

ç) të marrë masa të jashtëzakonshme në rastet e kërcënimeve që vijnë prej sëmundjeve të kafshëve;

d) të marrë pjesë në KKLAC.

6.6 Ministria përgjegjëse për turizmin

Në lidhje me lehtësirat, ministria përgjegjëse për turizmin luan rolin bashkëpunues për sinjalistikën e aeroportit, shërbimet e informacionit, lëvizshmërinë për turistët dhe trajtimin e grupeve të veçanta të pasagjerëve, në përputhje me Strategjinë Kombëtare në Fushën e Turizmit.

6.7 Operatorët ajrorë

Operatorët ajrorë duhet:

a) të trajtojnë efektivisht pasagjerët dhe kargon;

b) të informojnë pasagjerët, lidhur me kërkesat specifike të vendeve, në të cilat pasagjerët do të mbërrinjnë apo do të kalojnë transit;

c) të marrin masa paraprake për të garantuar që pasagjerët të kenë dokumentet e nevojshme të udhëtimit në kohën e hipjes në bord;

ç) të japin ndihmën e nevojshme për pasagjerët me nevoja të veçanta, duke përfshirë pasagjerët me lëvizje të kufizuara apo me aftësi të kufizuara;

d) të marrin pjesë në KKLAC dhe, nëse kërkohet, në takime të tjera, që kanë të bëjnë me lehtësirat.

6.8 Operatorët e aeroporteve

Operatorët e aeroporteve duhet të konsultohen vazhdimisht me operatorët ajrorë, agjencitë e kontrollit dhe palët e tjera të interesuara, në mënyrë që të garantohen lehtësitë e nevojshme dhe shërbimet e dhëna për përpunimin e konfirmimin e shpejtë për bagazhet, pasagjerët, ekuipazhin e stafin, postën dhe kargon.

Detyrat specifike të operatorëve të aeroporteve përfshijnë, por pa u kufizuar:

a) planifikimin e aeroportit në mënyrë të tillë që të ketë lehtësi në lëvizjen e pasagjerëve, stafit dhe bagazheve;



b) vendosjen e shenjave dhe të tabelave të rekomanduara, si dhe të pajisjeve për lehtësimin e lëvizjes së pasagjerëve në aeroport;

c) vendosjen e ekraneve të informacionit mbi fluturimet;

ç) përdorimin e pajisjeve të specializuara të sigurisë, kur është e nevojshme, në kontrollin e pasagjerëve në mënyrë që të minimizohet numri i pasagjerëve dhe i personave që duhet të kontrollohen me mënyra të tjera;

d) ofrimin e hapësirave të nevojshme për ruajtjen dhe kujdesin e shëndetit publik, ashtu si edhe hapësirave për vendosjen e karantinës për bimët e kafshët;

dh) ofrimin e hapësirave dhe të lehtësirave për agjencitë në ngarkim të kontrollit të lejeve në kushte jo më shumë apo më pak të favorshme se ato që aplikohen në operatorët aeroportualë apo përdoruesit, që kërkojnë hapësirë dhe lehtësira në një shkallë vlerësimi;

e) ofrimin, mirëmbajtjen dhe optimizimin e lehtësirave dhe shërbimeve për pasagjerët me nevoja të veçanta, duke përfshirë invalidët dhe personat me aftësi të kufizuara lëvizëse;

ë) organizimin e Komitetit të Lehtësirave të Aeroportit dhe/ose komiteve të përdoruesve të aeroportit;

f) pjesëmarrjen në Komitetin Kombëtar të Lehtësirave dhe, nëse kërkohet, në takime të tjera që kanë të bëjnë me lehtësirat.

6.9 Operatorët e shërbimit të përpunimit në tokë

Operatorët e shërbimit të përpunimit në tokë duhet:

a) të bashkëpunojnë ngushtë me agjencitë qeveritare për të garantuar lëvizjen e lehtë të pasagjerëve, kargos, bagazheve dhe postës me anë të shërbimeve dhe lehtësirave të aeroportit;

b) të marrin pjesë në Komitetin Kombëtar të Lehtësirave.

KAPITULLI 7

AGJENCITË PËRGJEGJËSE PËR ZBATIMIN E DISPOZITAVE TË SIGURISË SË AVIACIONIT

7.1 Mbërritja dhe nisja e avionëve

Në zhvillimin e procedurave që kanë për qëllim procedurat efektive të mbërritjes ose të nisjes së avionëve, institucionet e KKLAC-së duhet të marrin

parasysh zbatimin e masave të sigurisë së aviacionit dhe të kontrollit të narkotikëve, kur është e përshtatshme.

Ndërkohë që autoritetet përgjegjëse angazhohen të lehtësojnë në mënyrë eficiente dhënien e lejeve të fluturimit në mbërritjen dhe nisjen e avionëve, ato do të mbajnë një nivel të lartë sigurie në aviacion, zbatim efektiv të ligjit dhe një shërbim korrekt për klientët.

7.2 Mbërritja dhe nisja e pasagjerëve

Në zhvillimin e procedurave që kanë për qëllim zbatimin e efektshëm të kontroleve kufitare mbi pasagjerët dhe ekuipazhin, institucionet e KKLAC-së duhet të marrin parasysh zbatimin e sigurisë së aviacionit, integritetit kufitar, kontrollit të narkotikëve dhe emigracionit, kur është e përshtatshme.

Drejtoria përgjegjëse për lëshimin e pasaportave nuk duhet të zgjasë vlefshmërinë e dokumenteve të udhëtimit, të cilat janë të lexueshme elektronikisht.

Drejtoria përgjegjëse për lëshimin e pasaportave përditëson rregullisht elementet e sigurisë në dokumentet e udhëtimit. Kjo ndihmon në pengimin e falsifikimit të këtyre dokumenteve, duke përfshirë zbulimin e rasteve kur dokumente të tilla janë ndryshuar ose replikuar në mënyrë të paligjshme.

Kjo drejtori duhet të inkorporojë të dhëna biometrike në pasaportat elektronikisht të lexueshme, duke përdorur një ose më shumë nga teknologjitë opsionale të ruajtjes së të dhënave për të plotësuar zonën e lexueshme të makinerisë, siç është specifikuar në dokumentin 9303 të ICAO-s – Dokumentet e udhëtimit të lexueshme elektronikisht.

Të gjitha pasaportat e lëshuara nga Ministria e Brendshme do të jenë të lexueshme elektronikisht, në përputhje me specifikimet e dokumentit 9303, pjesa e parë – Pasaportat e lexueshme elektronikisht.

Ministria e Brendshme vendos kontrole në krijimin dhe lëshimin e dokumenteve të udhëtimit kundër vjedhjes së materialit stok të tyre dhe shpërdorimit të dokumenteve të udhëtimit të sapolëshuara.

Operatorët e avionëve duhet të marrin masat paraprake të nevojshme në pikën e nisjes për t'u siguruar që pasagjerët janë në posedim të dokumenteve të përshkruara nga shtetet e transitit dhe destinacionit për qëllime kontrolli.

Institucionet përgjegjëse për rendin dhe sigurinë duhet të sekuestrojnë dokumentet mashtruese, të



falsifikuara ose të përdorura për të imituar pronarin e ligjshëm të një dokumenti dhe t'ua kthejnë dokumentin autoriteteve përkatëse të shtetit.

7.3 Identifikimi dhe hyrja e ekuipazhit dhe e kategorive të tjera të personelit të operatorëve ajrorë

Kartat identifikuese të ekuipazhit duhet të lëshohen vetëm pasi është kryer një kontroll paraprak i pastërtisë së figurës nga AAC-ja, në përputhje me kërkesat kombëtare për këtë proces. Gjithashtu, në lidhje me lëshimin e kartave identifikuese të ekuipazhit duhet të aplikohen edhe kontrole të tjera, si: kontrolli i certifikimit, i statusit të punësimit apo i stokut të kartave bosh dhe mënyrës së ruajtjes së tyre.

7.4. Mbërritja dhe nisja e kargos dhe e artikujve të tjerë

Aty ku është e mundur, në mënyrë që të përmirësohet efienca, duhet të përdoren metoda moderne të kontrollit të sigurisë apo të ekzaminimeve, me qëllim lehtësimin e kontroleve fizike të kargos dhe artikujve në mbërritje apo në nisje.

7.5. Personat e papranueshëm dhe të deportuarit

Nëse drejtoria përgjegjëse për kontrollin kufitar dhe emigracionin ka arsye të besojë se një person i papranueshëm mund të rezistojë ndaj largimit të tij, atëherë kjo drejtori duhet të informojë operatorin ajror të prekur sa më parë të jetë e mundur nga koha e nisjes së avionit, në mënyrë që ky i fundit të marrë masa për sigurinë e fluturimit.

Drejtoria përgjegjëse për emigracionin dhe kontrollin kufitar, në momentin e përgatitjeve dhe të praktikave të largimit të personave të deportuar me operatorin e avionit, duhet t'i bëjë të mundur këtij të fundit informacionin e mëposhtëm, në një kohë sa më të shpejtë, por jo më vonë se 24 orë nga koha e planifikuar e fluturimit:

- a) kopje të urdhrat të largimit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) një vlerësim rrisht të kryer nga këto organe shtetërore dhe/apo çdo informacion tjetër, që mund t'i shërbejë operatorit ajror për të vlerësuar rrezikun në lidhje me sigurinë e avionit;
- c) emrin dhe shtetësinë e personave shoqëruar (escort), nëse aplikohet.

VENDIM

Nr. 573, datë 8.10.2025

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË NDRYSHIMIT NUMËR 1 TË PROTOKOLLIT ZBATUES, NË LIDHJE ME ASISTENCËN FINANCIARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 45/2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19 të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të ndryshimit numër 1 të protokollit zbatues, në lidhje me asistencën financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, ratifikuar me ligjin nr. 45/2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

PROTOKOLLI I NDRYSHIMIT NUMËR 1 I PROTOKOLLIT ZBATUES, NË LIDHJE ME ASISTENCËN FINANCIARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë (në vijim referuar si "Pala" individualisht dhe "Palët" bashkërisht),

Me dëshirën për të bërë ndryshime të nenit-II (Objekti), nenit-III (Autoritetet kompetente dhe pikat e kontaktit) dhe nenit-IV (Parimet e zbatimit) të Protokollit të Zbatimit për Asistencën Financiare, i cili ka hyrë në fuqi më datë 3 shtator 2020,



kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni-I

Neni-II (Objekti) i Protokollit të Zbatimit për Asistencën Financiare ndryshohet si më poshtë.

“Asistenca Financiare që do të ofrohet nga Qeveria e Republikës së Turqisë përfshin shpenzimet për transportin, ushqimin dhe akomodimin dhe tarifat e trajnimit/kursit për personelin e Gardës dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që do të marrin pjesë trajnime/seminare/konferenca/*workshop*-e/kurse që zhvillohen/bashkërendohen nga Qendra e Trajnimit “Partneriteti për Paqe”, Qendra Ekselencës për Luftën kundër Terrorizmit, Qendra e Ekselencës për Sigurinë Detare dhe qendrat e trajnimit pranë strukturës së Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë, si dhe shpenzimet për transportin, ushqimin dhe akomodimin e personelit të Gardës dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilat, në kuadër të zhvillimit të marrëdhënieve dypalëshe, do të marrin pjesë në vizita ushtarake zyrtare në Republikën e Turqisë dhe veprimtari të tilla, si: stërvitje, trajnime dhe ekzekutime të përbashkëta që do të zhvillohen në Turqi nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës së Turqisë.”

Neni-II

Neni-III (Autoritetet kompetente dhe pikat e kontaktit) i Protokollit të Zbatimit për Asistencën Financiare ndryshohet si më poshtë.

“Ky Protokoll zbatohet nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe nga Ministria e Mbrojtjes në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pikat e kontaktit për këtë Protokoll janë Zyra e Atasheut Ushtarak/Ambasada e Republikës së Turqisë, e akredituar në Republikën e Shqipërisë, dhe Zyra e Atasheut Ushtarak/Ambasada e Republikës së Shqipërisë, e akredituar në Republikën e Turqisë.”

Neni-III

Pikat 1 dhe 3 të Nenit-IV (Parimet e zbatimit) të Protokollit të Zbatimit për Asistencën Financiare ndryshohen si më poshtë:

“1. Fondi prej 3.500.000 TL (tre milionë e pesëqind mijë lira turke) do të alokohet i shtrirë në vite dhe në përputhje me kuadrin e legjislacionit kombëtar dhe shpërndarjet e buxhetit vjetor të Republikës së Turqisë.”

“3. Asistenca financiare që do të transferohet në llogarinë bankare të Zyrës së Atasheut Ushtarak të Republikës së Turqisë akredituar në Republikën e Shqipërisë nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës së Turqisë, përdoret nën mbikëqyrjen e Zyrës së Atasheut Ushtarak të Republikës së Turqisë akredituar në Republikën e Shqipërisë, në kuadër të udhëzimeve të Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë.”

Neni-IV

1. Ky Protokoll është pjesë plotësuese e Protokollit të Zbatimit për Asistencën Financiare dhe hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën, përmes kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të këtij Protokollit Ndryshimi.

2. Për kohëzgjatjen dhe përfundimin e këtij Protokollit zbatohen dispozitat e nenit IX të Protokollit të Zbatimit për Asistencën Financiare.

Neni-V

Ky Protokoll përgatitet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, në gjuhën turke dhe në gjuhën angleze, ku secila kopje është (njëlloj) autentike. Në rast mosmarrëveshjes që mund të lindin nga zbatimi i këtij Protokollit, do të ketë përparësi teksti në gjuhën angleze.

Në dëshmi të sa më sipër, të nënshkruarit, duke qenë përfaqësues të autorizuar rregullisht të të dyja Palëve, kanë nënshkruar këtë Protokoll më, në Istanbul, dhe më....., në 23.7.2025.

NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NËN SHKRIMI

EMRI: Pirro VENUGU

POZICIONI: Ministër i Mbrojtjes



NË EMËR TË QEVERISË SË REPUBLIKËS
SË TURQISË
NËNSHKRIMI:

EMRI: Yaşar GÜLER

POZICIONI: Ministër i Mbrojtjes Kombëtare

URDHËR

Nr. 970, datë 7.10.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Lubelskie	Biała Podlaska	Janów Podlaski*
Lubelskie	Radzyń Podlaski	Czemierniki*
Lubelskie	Bilgoraj	Tarnogród*
Lubelskie	Hrubieszów	Dolhobyczów*
Lubelskie	Tomaszów Lubelski	Ułhówek*
Pomorskie	Wejherowo	Luzino*
Wielkopolskie	Śrem	Brodnica*
Zachodniopomorskie	Choszczno	Recz*
Zachodniopomorskie	Kamień	Golczewo*
Zachodniopomorskie	Łobez	Dobra*
Zachodniopomorskie	Stargard	Chociwel*
Zachodniopomorskie	Gryfice	Trzebiatów*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha

kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Polonisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.



2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërtetohet se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërtetohet se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të nenëve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të



derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre,

materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 868, datë 9.9.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 971, datë 7.10.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË DERMATOZËS
NODULARE TË GJEDHIT (*LUMPY
SKIN DISEASE*) NË SHTETIN
E SPANJËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga i gjithë territori i Republikës së Spanjës në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- gjithë kafshëve të gjalla të llojit gjedh dhe buajve të ujit;

- qumështit të papasterizuar, ku nuk është arritur shkatërrimi i virusit dhe që nuk janë marrë masat e nevojshme paraprake pas përpunimit të tij për të shmangur kontaktin e qumështit me çdo burim të mundshëm të virusit të Dermatozës Nodulare të Gjeshit;

- spermën dhe embrionet e kafshëve të llojit gjedh dhe të buajve të ujit;



- miellit të mishit, miellit të gjakut, mishit të ndryshëm nga mishi i muskujve skeletorë ose kocka nga kafshët e llojit gjedh dhe nga buajt e ujit;

- lëkurës së patrajtuar ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit dhe që nuk janë marrë masat e nevojshme paraprake pas përpunimit të tij për të shmangur kontaktin e lëkurëve të patrajtuara me çdo burim të mundshëm të virusit të Dermatozës Nodulare të Gjedhit.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të llojit të llojit gjedh dhe të buajve të ujit, qumështit, spermës dhe embrioneve të kafshëve të llojit gjedh dhe të buajve të ujit, miellit të mishit, miellit të gjakut, mishit të ndryshëm nga mishi i muskujve skeletorë ose kocka dhe lëkurëve të patrajtuara të kafshëve të llojit gjedh dhe të buajve të ujit, për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

3. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë e të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të llojit gjedh dhe buajve të ujit, qumështit, spermës dhe embrioneve të kafshëve të llojit gjedh dhe të buajve të ujit, miellit të mishit, miellit të gjakut, mishit të ndryshëm nga mishi i muskujve skeletorë ose kocka dhe lëkurëve të patrajtuara të kafshëve të llojit gjedh dhe të buajve të ujit.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR

Nr. 972, datë 7.10.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E BOSNJË- HERCEGOVINËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nga i gjithë territori i Bosnjë-Hercegovinës në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

3. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.



Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 973, datë 7.10.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË SHTETIN E BELGJIKËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Belgjikës, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë*
Wallonie	Liège	Liège*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga

vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose



iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitruapat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 192 lekë